

L I G J
Nr.8091, datë 21.3.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7786, DATË 27.1.1994 “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT PERSONALE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7897, DATË 2.2.1995**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale” ndryshuar me ligjin nr.7897, datë 2.2.1995, bëhen këto ndryshime:

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“Të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet për shërbime individuale deri në 10 000 lekë në muaj përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale”.

Neni 5 ndryshohet si vijon:

“Tatimi mbi të ardhurat personale për pagat e shpërblimet për shërbimet individuale caktohet si vijon:

1. Të ardhurat nga 10 001-20 000 lekë në muaj, shuma mbi 10 000 lekë në muaj tatohet 5 për qind.
2. Të ardhurat nga 20 001-30 000 lekë në muaj tatohen 500 lekë plus 10 për qind të shumës mbi 20 000 lekë.
3. Të ardhurat nga 30 001-60 000 lekë në muaj tatohen 1500 lekë plus 15 për qind të shumës mbi 30 000 lekë.
4. Të ardhurat mbi 60 000 lekë në muaj tatohen 6000 lekë plus 20 për qind të shumës mbi 60 000 lekë.

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Tatimi mbi të ardhurat personale për veprat krijuese është 5 për qind dhe për llojet e tjera të të ardhurave personale është 10 për qind”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1444, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha